



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARIA M. DANO
ADRESA Mihal Duri, Nr. 4
TEL: 694099966

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1004

Nr. koleksioni: 210

Tirane më 24/02/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023053190024278257



A2023053190024278257

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI****(TË SHOQËRISË "RING MEDIA" SH.P.K)**

Sot, më datë 24/02/2023, para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

SHITES:

Z. Aleksandër Prifti, [redacted] shtetas Shqiptar, lindur në Ersekë, Kolonjë dhe banues në KAMËZ, me adresë [redacted] lindur më [redacted] gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID [redacted] dhe nr. personal [redacted]

Znj. Monila Karaj, atësia Besnik, amësia Zyhra, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zogu 1; Nd. 18; H. 5; Ap. 5; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 12/02/1989, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036205698 dhe nr. personal I95212076G.

BLERES:

Znj. Olsiana Totaj, atësia Ruzhdi, amësia Anita, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në TIRANË, me adresë Todi Shkurti; Nd. 32; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 17/01/1985, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035267776 dhe nr. personal I55117040B.

Z. Alban Rrokaj, atësia Bajram, amësia Tefta, shtetas Shqiptar, lindur në Krume, Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë Njesia Nr.3 K.Manastirit; Nd. 46/9; H. 1; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 3; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 24/11/1984, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032390020 dhe nr. personal I41124037H.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "RING MEDIA" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**NENI I
OBJEKTI**

Kjo kontratë ka për objekt shitblerjen e kuotave të kapitalit që pala shitese zoteron në shoqërinë "RING MEDIA"-SH.P.K. nga ortaket e shoqërisë si me poshte vijon:

Shitblerjen e 1 kuote që përbën 33 % (tridhjetë e tre përqind), nga 100 % të vlerës së kapitalit themeltar që zoteron pala shitëse **Z. Aleksandër Prifti**, në kapitalin e shoqërisë "RING MEDIA" - SH.P.K, që janë prone e pales shitese dhe të të gjitha të drejtave që lidhen me to.

Shitblerje e 1 kuote që përbën 33 % (tridhjetë e tre përqind), nga 100 % të vlerës së kapitalit themeltar që zoteron pala shitëse **Znj. Monila Karaj**, në kapitalin e shoqërisë "RING MEDIA" - SH.P.K, që janë prone e pales shitese dhe të të gjitha të drejtave që lidhen me to.

Pala blerese **Znj. Olsiana Totaj**, i blen pales shitese, **Z. Aleksandër Prifti**, 1 kuote që përbën 33 % (tridhjetë e tre përqind), nga kapitali i Shoqërisë "RING MEDIA" Sh.P.K, korrespoduese të 1 kuote në Shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K;



A2023053190024278257

Pala blerese **Znj. Olsiana Totaj**, i blen pales shitese, **Znj. Monila Karaj**, 1 kuote që përbën 17 % (shtatëmbëdhjetë përqind), nga kapitali i Shoqërisë "RING MEDIA" Sh.P.K., korresponduese te 1 kuote në Shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K.;

Pala blerese **Z. Alban Rrokaj**, i blen pales shitese, **Znj. Monila Karaj**, 1 kuote që përbën 16 % (gjashtëmbëdhjetë përqind), nga kapitali i Shoqërisë "RING MEDIA" Sh.P.K., korresponduese te 1 kuote në Shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K.;

NENI 4 ÇMIMI

1. Çmimi i shitjes se 1 (një) kuote, që përbën 33 % (tridhjetë e tre per qind), nga 100 % te vleres se kapitalit themeltar qe zoteron pala shitëse, **Z. Aleksandër Prifti**, ne shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K., eshte ne shumen e pergjithshme prej 33 000 (tridhjetë e tremije) Lekë, me blerës **Znj. Olsiana Totaj**.
2. Çmimi i shitjes se 1 (një) kuote, që përbën 17 % (shtatëmbëdhjetë per qind), nga 100 % te vleres se kapitalit themeltar qe zoteron pala shitëse, **Znj. Monila Karaj**, ne shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K., eshte ne shumen e pergjithshme prej 17 000 (shtatëmbëdhjetë mije) Lekë, me blerës **Znj. Olsiana Totaj**.
3. Çmimi i shitjes se 1 (një) kuote, që përbën 16 % (gjashtëmbëdhjetë per qind), nga 100 % te vleres se kapitalit themeltar qe zoteron pala shitëse, **Znj. Monila Karaj**, ne shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K., eshte ne shumen e pergjithshme prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mije) Lekë, me blerës **Z. Alban Rrokaj**.

Likujdimi i çmimit të percaktuar ne piken 1 te ketij neni, nga pala blerese tek pala shitese, eshte kryer jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk kane asnje kundershtrim dhe mosmarreshje per kete fakt ne kohen e redaktimit dhe nenshkrimt te kesaj kontrate.

NENI 5 DETYRIMET E PALEVE

Detyrimet e pales shitese:

- a. Merr persiper dhe deklarone se jane pronarë, me një kuote secili, që përbën në total 67 % (gjashte dhjetë e shtatë përqind), nga 100 % te vleres se kapitalit themeltar qe zoteron pala shitëse ne shoqërinë "RING MEDIA" Sh.P.K., me nje çmim te pergjithshëm prej 66 000 (gjashtëdhjetë e gjashtë mije) Lekë, pagese te cilen e kane marre jashte kesaj zyre noteriale sipas percaktimit ne nenin 5 te kesaj kontrate.
 - b. Garantojne palen blerese, se keto kuota jane te lire nga çdo barresim dhe detyrim karshi te treteve dhe per çdo pretendim qe mund te ngrene te tretet per cenimin e te drejtese se pronesise se pales blerese (eviksjon), dhe eshte i gateshem dhe i detyruar te paraqiten menjehere me kerkesen e pales blerese dhe te cdo personi tjeter te trete, qe pretendon mbi keto kuota, para gjithë organeve gjyqesore dhe administrative per te mbrojtur te drejten e tyre, si pronar te ligjshem i ketyre kuotave pas nenshkrimt te kesaj kontrate.
- 2 **Detyrimet e pales blerese:**
 - a. Pala blerese do te marre ne dorëzim kuotat pasi te kete likujduar palen shitese kundrejt cmimit te percaktuar ne nenin 5 te kesaj kontrate, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.
 - 3 **Detyrimet dy paleshe:**
 - a) Palet kontraktuese deklarone se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate shitje jane realizuar prej tyre dhe ata nuk kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre.



A2023053190024278257

a) Palet kontratuëse deklarojne se kuotat do te merren ne dorëzim nga pala blerëse në gjendjen ekzistuese dhe ata nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

NENI 6

PASOJAT TRANZITORE TE KALIMIT TE AKSIONEVE

Pala shitese është solidarisht pergjegjes ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotrimi i aksioneve objek i kesaj kontrate deri ne çastin e kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate ne favor te pales blerese, ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.

Pala Blerese deklarone se merr persiper te gjitha detyrimet e Shoqerise dhe zotohet per likujdimin e tyre. Pala Blerese deklarone se nuk do te kete me asnje pretendim kundrejt pales shitese, as sot dhe as ne te ardhmen per detyrime te pa likujduara te pales shitese me cilesine e ortakeve te Shoqerise "RING MEDIA" shpk.

NENI 7

EFEKTET E KONTRATES

Kalimi i pronesisë se kuotave nga pala shitese tek pala blerese ne perputhje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrata prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.

Kalimi i kuotave sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.

Regjistrim i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

NENI 8

SHPENZIMET NOTERIALE

Shpenzimet noteriale te kontratës janë në ngarkim të blerësit.

NENI 9.

DISPOZITA E FUNDIT

Keshtu me firmosjen e kesaj kontrate nga palet kontratuëse dhe nenshkrimin e saj nga une noteria, pala shitese zhvishet nga pronesia për 66 % (gjashtëdhjetë e gjashtë per qind), te kapitalit themeltar te shoqerise dhe pronar i tyre behet Z. Alban Rrokaj dhe Znj. Olsiana Totaj, duke gezuar te gjithë te drejtat ligjore mbi keto kuota ne shoqerine "RING MEDIA" Sh.P.K. Pas kësaj shitjeje numri i kuotave të shoqërisë është dy kuota ku:

Z.Alban Rrokaj, mbetet ortak i shoqerise "RING MEDIA" Sh.P.K. me 1 kuote që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind), te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlerë kapitali 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Znj. Olsiana Totaj, bëhet ortak i shoqerise "RING MEDIA" Sh.P.K. me 1 kuote që përbëjnë 50 % (pesëdhjetë përqind), te kapitalit themeltar te shoqerise., me vlerë kapitali 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Palet deklarone se morren dijeni per kryerjen e regjistrimit te ketij akti noterial ne QKB Tirane sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

DOKUMENTET E BASHKELIDHURA

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të jene pjese perberese e Kontratës;

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "RING MEDIA" Sh.p.k.





A2023053190024278257

- Informacioni i marrë nga Rëgjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.
- Vendimi i ortakëve të shoqërisë.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET KONTRATUESE

PALA SHITËSE

Z. Aleksandër Prifti Aleksander Prifti

Znj. Monila Karaj Monilla Karaj

PALA BLERESE

Z. Alban Rrokaj Alban Rrokaj

Znj. Olsiana Totaj Olsiana Totaj



NOTER / MARIA M. DANO

Maria M. Dano

**VENDIM I ASAMBLESE
TE
ORTAKEVE TE VETEM TE SHOQERISE
"RING MEDIA" SH.P.K**

Nr. 1 , Date 23/02/2023

Ky vendim u mor sot, me datë 23/02/2023, ne seline e shoqerise "RING MEDIA" Sh.P.K. Shoqeria "RING MEDIA" - Sh.P.K eshte person juridik shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me nr. NIPT M21606026L, me nje kapital prej 100 000 (njëqind mije) Lekë.

Ortaket e shoqerise jane:

- **Alban Rrokaj**, i cili zoteron 1 (një) kuote, që përbën 34 % (tridhjetë e katër) te kapitalit themeltar te shoqerise, njekohesisht dhe Administrator i shoqerise.
- **Aleksandër Prifti**, 1 (një) kuote, që përbën 33 % (tridhjetë e tre) te kapitalit themeltar te shoqerise,
- **Monila Karaj**, e cila zoteron 1 (një) kuote, që përbën 33 % (tridhjetë e tre) te kapitalit themeltar te shoqerise, te kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja eshte mbledhur per te vendosur ne lidhje me pikat e rendit te dites:

- a. Miratimin e transferimit te kuotave qe perbejne ne total 66 % te kapitalit, nga 100 % te kapitalit te shoqerise, te zoteruara nga ortaket e shoqerise Aleksandër Prifti dhe Monila Karaj, ne kapitalin e shoqerise "RING MEDIA" - SH.P.K.
- b. Blerjen e 50 % te kapitalit te shoqerise "RING MEDIA" SH.P.K. nga Znj. Olsiana Totaj
- c. Blerjen e 16 % te kapitalit te shoqerise "RING MEDIA" SH.P.K. nga Z. Alban Rrokaj

Pas kësaj shitjeje numri i kuotave të shoqërisë është dy kuota ku:

- d. **Z. Alban Rrokaj**, mbetet ortak i shoqerise "RING MEDIA" Sh.P.K. me 1 kuote që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind), te kapitalit themeltar te shoqerise.
- e. **Znj. Olsiana Totaj**, bëhet ortak i shoqerise "RING MEDIA"-Sh.P.K. me 1 kuote që përbëjnë 50 % (pesëdhjetë përqind), te kapitalit themeltar te shoqerise.
- f. Te tjera eventuale.

Pasi shqyrtoi me kujdes pikat e rendit te dites, Asambleja e Ortakut te Vetem te Shoqerise, me vullnet te lire dhe te plote:

VENDOSI:

- Transferimin të 33 % te kapitalit, nga 100 % te kapitalit te shoqerise, me vlerë kapitali 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë, te zoteruara nga ortaku i shoqerise Aleksandër Prifti, ne kapitalin e shoqerise "RING MEDIA" - SH.P.K.
- Transferimin të 33 % te kapitalit, nga 100 % te kapitalit te shoqerise, me vlerë kapitali 33 000 (tridhjetë e tre mijë), te zoteruara nga ortaku i shoqerise Monila Karaj, ne kapitalin e shoqerise "RING MEDIA" - SH.P.K.
- Blerjen e 50 % te kapitalit, nga 100 % te kapitalit te shoqerise, me vlerë kapitali me vlerë kapitali 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, nga Znj. Olsiana Totaj.
- Blerjen e 16 % te kapitalit, nga 100 % te kapitalit te shoqerise, me vlerë kapitali 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, nga Z. Alban Rrokaj.
- Si perfundim shoqeria do te ketë përbërjen nga 2 kuota:



- Z. Alban Rrokaj, të jetë ortak i shoqërisë "RING MEDIA" Sh.P.K. me 1 kuote që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind), të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën e kapitalit 50 (pesëdhjetë) mijë leke .
- Znj. Olsiana Totaj, të jetë ortak i shoqërisë "RING MEDIA" Sh.P.K. me 1 kuote që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind), të kapitalit themeltar të shoqërisë, në vlerën e kapitalit 50 (pesëdhjetë) mijë leke .
- Depozitimin e këtij vendimi dhe marrëveshjes perkatese të transferimit të kuotes në QKB Tirane.
- Shoqëria nuk ben ndryshime të tjera të cilat mbeten siç kane qene.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"RING MEDIA" - SH.P.K**

Alban Rrokaj Alban Rrokaj

Aleksandër Prifti Aleksander Prifti

Monila Karaj Monila Karaj

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M21606026L
2. Data e Regjistrimit	06/04/2022
3. Emri i Subjektit	RING MEDIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	04/04/2022
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/04/2022
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Xhorxh W. Bush", Pallati Kasmir, Kati i katert, zyra Nr. 307.
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00
9. Objekti i aktivitetit	Digital Marketing, Agjensi Marketingu me objekt shërbimesh konsulence marketingu, strategji marketingu, krijim identiteti të biznesit, brandim, krijim imazhi online, dizajnim logo, emer biznesi, produksione fotografi dhe video. Fushata publicitare, marrëdhënie me publikun-PR, planifikim mediatik, negocimin me median e për monitorimin e kanaleve televizive, dhe zhvillim imazhi për individë dhe kompani, Programming, Zhvillim programesh në të gjitha platformat për web, desktop, mobile etj duke përfshirë proceset e analizës planifikim, implementim, mirëmbajtje. Ndermjetesim në trajnimë dhe kurse profesionale në fushën e zhvillimit të programeve dhe IT, Print, Dizajn produktesh, printim dhe shtyp, proçime dhe shpërndarje printimi të të gjitha llojeve duke përfshirë: kartvizita, fletpalosje, ftesa, flyer, banner, rollup, menu, revista, libra etj. Reklama Exterior, Projektim exterior në funksion të rritjes së vizibilitetit dhe imazhit të një exterior. Dizajnim dhe prodhim tabelash: germa 3d, tabela me ndricim, forex, adeziva, letra murale, punime plexiglass etj. Marka Tregtare, Shërbim konsulence ligjore për rregjistrimin e markave tregtare, ndjekje e procedurave të aplikimit dhe keshillim ligjor për të drejtat e rregjistrimit të markave tregtare, agjensi Imobiliare, Agjensi turistike, Shitje me shumicë dhe pakicë, Konsulence dokumentacionesh për shërbimet e institucioneve shtetërore,



	Ndermarrja perfaqesimit per kompani te huaja. Gjithashtu shoqeria mund te ushtroj edhe cdo lloj aktiviteti tjetër te pashprehur me sipër, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.	
10. Administratori/ët	Alban Rrokaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 04/04/2022	Deri: 04/04/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Alban Rrokaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 34.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	34,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	Aleksandër Prifti <i>1100</i>	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 33.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Ortakët	Monila Karaj <i>1100</i>	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 33.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: RING MEDIA E-Mail: info@ringmedia.al Telefon: 0693121191	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 23/02/2023



Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-2023022411012530
Data e Rezultatit të Kerkimit: 24.02.2023
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 11:00:12AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-203-1835
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ALEKSANDËR VIKTOR PRIFTI
RING MEDIA SH.P.K.
MONILA BESNIK KARAJ

